



Jeni përdhunuar apo sulmuar seksualisht ju apo dikush që njihni?

Personeli i The Ferns është këtu që t'u ndihmojë.

The Fern është një qendër për referimet në rastet e sulmeve seksuale dhe ofron kujdes mjeko-ligjor e mbështetje emocionale për gjithë viktimat e sulmeve seksuale.

Sulmi seksual mund t'i ndodhë gjithkujt; grave, fëmijëve dhe burrave. Këtu në The Fern, ne mund t'u ofrojmë një vend përkrahës, si dhe mbështetje praktike dhe emocionale për t'ju ndihmuar që të rikuperoheni.

Është zgjedhja juaj

The Fern nuk do t'u bëjë presion që të kontaktoni policinë. Ne jemi këtu që t'u ofrojmë mbështetjen që ju nevojitet dhe do të respektojmë çfarëdo vendimi që të merrni.

Nëse doni të përfshini policinë ne mund t'u shpjegojmë se si ta bëni këtë dhe mund t'u mbështesim gjatë këtij procesi.

Çështja juaj dhe informacioni që na jepni do të trajtohen në fshehtësi të rreptë dhe vetëm çështjet që përfshijnë fëmijë ose të rritur vulnerabël do të raportohen automatikisht te shërbimet përkatëse, si pjesë e detyrës tonë për t'u kujdesur.

Kohë për t'u menduar

Ne mund t'i ruajmë të sigurtat provat e marra nga ekzaminimi juaj dhe nëse vendosni ta raportoni çështjen në polici më vonë, ne mund t'u ndihmojmë me këtë proces.

Siguria

Siguria juaj është shumë e rëndësishme dhe ne do t'u japim këshilla nëse keni shqetësime për sigurinë pas një sulmi seksual. Nëse jeni të shqetësuar për sigurinë tuaj në çdo kohë, lutemi kontaktoni policinë në numrin 101.

Në rast emergjence telefononi 999

Çfarë duhet bërë nëse jeni sulmuar seksualisht ose jeni përdhunuar:

1. Nëse nuk doni që të përfshihet policia dhe nuk jeni në rrezik, kontaktoni:
The Ferns në numrin **0300 123 5058** (nga ora 9 deri në 5)
Email: **contact@theferns-suffolk.org.uk**
2. Ruajini të palara të gjitha rrobat që kishit veshur në kohën e sulmit dhe nëse është e mundur vendosini në një qese prej letre.
3. **MOS:**
 - Bëni dush, mos u lani në vaskë ose mos u pastroni
 - Lani dhëmbët
 - Prekni asgjë në vendin ku ka ndodhur sulmi
4. Nëse jeni përdhunuar ose jeni sulmuar seksualisht dhe ju nevojitet ndihmë emergjente nga policia, telefononi 999 dhe shkoni në një vend të sigurt. Nuk jeni të detyruar të kaloni nëpërmjet një doktori ose profesionisti tjetër për të folur me ne, thjeshtë mund të na kontaktoni direkt.



Për më shumë informacion lutemi vizitoni:

www.theferns-suffolk.org.uk